

SYLLABUS I LËNDËS: Bazat e menaxhmentit

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Ekonomisë
Titulli i lëndës:	Bazat e menaxhmentit
Niveli:	Bachelor
Statusi lëndës:	Obligative
Viti i studimeve:	Viti I, Semestri I
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi – ECTS:	5
Koha / lokacioni:	Përcaktohet nga Dekanati
Mësimdhënësi:	Prof. asst. Liridon Veliu
Detajet kontaktuese:	liridon.veliu@uni-pr.edu
Përshkrimi i lëndës	Lënda “Bazat e menaxhmentit” ofron njohuri themelore mbi funksionet kyçe të menaxhimit, si planifikimin, organizimin, udhëheqjen dhe kontrollin, duke i lidhur ato me praktikatat aktuale në organizatat publike, private dhe startup-e, veçanërisht në kontekstin ekonomik të Kosovës. Studentët do të analizojnë teori menaxheriale klasike dhe moderne, qasje gjatë krizave dhe transformimeve teknologjike, si dhe do të analizojnë struktura organizative dhe zhvillimin e kulturës inovative. Lënda përfshin raste studimore dhe ushtrime praktike për zhvillimin e aftësive analitike, vendimmarrëse dhe udhëheqëse, të nevojshme për tregun e sotëm të punës. Lënda synon të pajisë studentët me njohuri themelore dhe të integruara mbi konceptet, teoritë dhe funksionet kryesore të menaxhimit, me theks te balanca ndërmjet teorisë dhe praktikës.
Qëllimet e lëndës	Zhvillimi i aftësive analitike dhe praktike për aplikimin e proceseve menaxheriale në organizata publike dhe private. Studentët do të përgatiten për të ushtruar funksionet bazë të menaxhimit, duke u mundësuar të përballen me sfidat e mjedisit dinamik dhe të konkurojnë në tregun bashkëkohor të punës. Përveç kësaj, lënda synon të pajisë studentët me njohuri mbi teoritë klasike dhe moderne të menaxhmentit dhe mënyrën e aplikimit të tyre në situata reale, duke zhvilluar aftësi vendimmarrëse dhe zgjidhjeje të problemeve në kontekstin e ndryshimeve organizative dhe teknologjike. Gjithashtu, ajo nxit zhvillimin e aftësive komunikative dhe bashkëpunuese, të nevojshme për menaxhimin efektiv të ekipeve dhe ndërtimin e strukturave organizative funksionale, duke promovuar kulturën inovative dhe adaptimin ndaj sfidave të krizave dhe transformimeve të vazhdueshme. Në këtë mënyrë, studentët do të jenë të përgatitur për të integruar njohuritë teorike me aftësitë praktike dhe për të konkurruar me sukses në tregun modern të punës.

Rezultatet e pritura të nxënies	<p>Në përfundim të lëndës, studentët pritet të jenë në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Kuptojnë menaxhmentin si proces dhe si strukturë organizative, duke përvetësuar njohuri themelore mbi funksionet thelbësore të tij dhe rëndësinë që ato kanë në funksionimin e organizatave - Zotërojnë njohuri mbi komunikimin efektiv dhe parimet për ndërtimin e strukturave organizative të suksesshme - Identifikojnë dhe analizojnë rolet kryesore të udhëheqjes dhe organizimit në mjedisin e biznesit - Zhvillojnë aftësinë për të interpretuar rolet ndërpersonale brenda grupeve të punës dhe të kuptojnë konceptet dhe terminologjinë themelore të menaxhmentit - Aplikojnë njohuritë e fituara në praktikë përmes vendimmarrjes, zbatimit të funksioneve menaxheriale dhe përdorimit të teknikave të ndryshme për menaxhim dhe drejtim të suksesshëm të organizatave 		
Kontributi në ngarkesën e studentit			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithsej
Ligjërata	2	13	26
Ushtrime	1	15	15
Punë praktike	0	0	0
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	20 min.	15	5
Ushtrime në teren	/	/	/
Kollokviume	2	2	4
Koha e studimit vetanak të studentit	3	15	45
Përgaditja përfundimtare për provim	2	10	20
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	3	2	6
Projekte, prezantime	1	4	4
Totali			125
Metodologjia e mësimdhënies	Ligjërata, ushtrime, diskutim në klasë, prezantim dhe debat i punimeve seminarike.		
Metodat e vlerësimit	<p>Vlerësimi i dijeve dhe aftësive të fituara bëhet përmes:</p> <p>a) vijueshmërisë në ligjërata dhe ushtrime: 10 pikë</p> <p>b) aktivitetit dhe punimi seminarik: 10 pikë</p> <p>c) testi i parë: 40 pikë</p> <p>d) testi i dytë: 40 pikë</p> <p>Gjithsej: 100 pikë</p> <p>Vlerësimi i provimit përfundimtar, që vlerësohet me 51% të suksesit, me një sistem të ndërtimit të mëtejshëm të notës përfundimtare me kriteret tjera të lartë theksuara.</p>		
Metodat e vlerësimit të rezultateve në të nxënë	<p>Zotërimi i koncepteve dhe funksioneve themelore të menaxhmentit</p> <p><i>(Përmbajtjen e lëndës mbi funksionet kryesore të menaxhmentit: planifikimi, organizimi, udhëheqja, kontrolli)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Provime të strukturuar me shkrim (midterm dhe finale) 		

	<p>për testimin e njohurive teorike</p> <ul style="list-style-type: none"> - Ese analitike mbi temat kryesore të menaxhmentit - Kuize për forcimin e kuptimit të teorive klasike dhe moderne <p>Aftësia për të aplikuar proceset menaxheriale në organizata publike, private dhe startup <i>(Zhvillimin e aftësive praktike, analizën e rasteve studimore dhe aplikimin e teorisë në kontekste të ndryshme organizative)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Ushtrime praktike dhe simulime mbi planifikimin, organizimin, vendimmarrjen dhe delegimin - Analiza dhe prezantime të rasteve studimore që reflektojnë sfidat reale në mjedise të ndryshme - Simulime dhe lojëra roli mbi skenarë menaxherialë për praktikë të drejtpërdrejtë <p>Analiza dhe vlerësimi i roleve të udhëheqjes dhe strukturave organizative <i>(Mësimin për strukturat organizative, udhëheqjen dhe kulturën inovative)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekte kërkimore grupore mbi modelet e udhëheqjes dhe strukturat organizative të suksesshme - Prezantime mbi aftësitë e komunikimit dhe rolet ndërpersonale brenda ekipeve - Feedback nga bashkëstudentët dhe pedagogët për vlerësimin e kuptimit të stileve të udhëheqjes <p>Zhvillimi i aftësive ndërpersonale, vendimmarrëse dhe zgjidhjes së problemeve <i>(Aftësitë analitike, vendimmarrëse dhe menaxheriale të nevojshme në tregun e punës bashkëkohor)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Debate tematike dhe ese reflektuese mbi motivimin, menaxhimin e ndryshimit dhe trajtimin e krizave - Diskutime bashkëpunuese grupore mbi rolet ndërpersonale në grupe pune - Simulime të fokusuar në vendimmarrje në kushte të pasigurta dhe dinamike <p>Integrimi i teorisë dhe praktikës në menaxhment <i>(Qëllimi për të balancuar teorinë dhe praktikën përmes rasteve studimore dhe ushtrimeve praktike)</i></p> <ul style="list-style-type: none"> - Projekte përfundimtare që kombinojnë njohuritë teorike me zgjidhje praktike organizative - Vlerësim i vazhdueshëm përmes pjesëmarrjes në seminare dhe punëtori praktike - Vetëvlerësim dhe vlerësim nga bashkëstudentët për zhvillimin e mendimit kritik dhe aftësive vetëreflektuese
Literatura	
Literatura bazë:	Robbins, S., Coulter, M., & DeCenzo, D. (2021). Bazat e menaxhimit (Botimi i njëmbëdhjetë). Tiranë: UET Press. ISBN: 9789928448842. Përkthyer nga Rezart Prifti;

Literatura shtesë:	Ramosaj, B. (2013). Management / Bazat e menaxhimit. Universiteti i Prishtinës, Prishtinë; Schermerhorn, J. R., & Bachrach, D. G. (2023). Management (15th ed.). Wiley.
Plani i dizajnuar i mësimit	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
<i>Java e I-rë:</i>	Prezantimi i syllabusit / Menaxhmenti si shkence
<i>Java e II-të:</i>	Menaxherët dhe menaxhimi
<i>Java e III-të:</i>	Mjedisi menaxherial
<i>Java e IV-të:</i>	Menaxheri si planifikues dhe strateg
<i>Java e V-të:</i>	Organizimi si funksion i menaxhmentit
<i>Java e VI-të:</i>	Modelet e vendimmarrjes
<i>Java e VII-të:</i>	Testi i pare
<i>Java e VIII-të:</i>	Personeli si funksion i menaxhmentit
<i>Java e IX-të:</i>	Roli i udhëheqësve në organizata dhe stilet e lidërshiptit
<i>Java e X-të:</i>	Motivimi dhe format e motivimit
<i>Java e XI-të:</i>	Kontrolli organizativ
<i>Java e XII-të:</i>	Kultura organizative dhe nxitja e inovacionit
<i>Java e XIII-të:</i>	Menaxhimi i ndryshimit dhe transformimi digjital në organizata
<i>Java e XIV-të:</i>	Etika në menaxhment dhe përgjegjësia sociale e biznesit
<i>Java e XV-të:</i>	Testi i dytë

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Pjesëmarrja në ligjërata dhe ushtrime është e obligueshme. Studentët inkurajohen që gjithmonë të kërkojnë sqarime gjatë ligjëratave dhe ushtrimeve. Mësimdhënësi do të jetë në dispozicion për sqarime shtesë dhe konsultime të studentëve. Studentët kanë për obligim që pas çdo ligjërata të lexojnë së paku literaturën që ju është caktuar dhe të kryejnë detyrat dhe esetë që do t'u jepen. Studentët nuk janë të obliguar tu nënshtrihen vlerësimeve gjatë semestrit.

Studenti duhet të jetë i ndërgjegjshëm dhe të respektojë institucionin dhe rregullat studimore. Duhet të respektojë orarin e ligjëratave, ushtrimeve dhe të jetë i vëmendshëm në ligjërata.

Është i obliguar posedimi dhe paraqitja e ID kartelës në teste dhe provim. Gjatë hartimit të punimeve seminarike, studenti duhet t'i përmbahet udhëzimeve të dhëna nga mësimdhënësi për realizimin hulumtues dhe teknik të punimit.